



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:186686

Datë: 30.08.2024

Numri i dokumentit: 06110675

KA.nr.475/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Albi Shopping” SH.P.K, me seli në Zonën Industriale-Veternik, Prishtinë, e përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i Republikës së Kosovës, me seli në Fushë Kosovë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit AUV.ref.04/02-2333/2020 të datës 04.12.2020, pas shqyrtimit kryesor publik me datë 22.08.2024, në mungesë të përfaqësuesit të paditurit konform nenit 41 të LKA , dhe në prezencë të përfaqësuesit të paditësit, me datë 30.08.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Albi Shopping” SH.P.K, me seli në Zonën Industriale-Veternik, Prishtinë, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i Republikës së Kosovës, me seli në Fushë Kosovë, për shkak të anulimit të vendimit AUV.ref.04/02-2333/2020 i datës 04.12.2020, **si e pabazuar**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 29.12.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, “Albi Shopping” SH.P.K, me seli në Zonën Industriale-Veternik, Prishtinë, në kohën e parashtrimit të padisë e përfaqësuar nga “Kërveshi & Partners”, bazuar në shkresat e lëndës me autorizim të datës 14.03.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i Republikës së Kosovës, me seli në Fushë Kosovë, për shkak të anulimit të vendimit AUV.ref.04/02-2333/2020 i datës 04.12.2020, me propozim që Gjykata të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, të anulojë si të kundërligjshëm vendimin e kundërshtuar dhe Fletë përmbajtjen e Inspektoratit Sanitar me nr.003616 i datës 04.11.2020. Lënda është evidentuar me nr. A.2261/2020.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr.475/22.
3. Seanca e shqyrtimit gjyqësor u mbajt me datë 22.08.2024, në prezencë të përfaqësuesit të paditësit, e përfaqësuar nga Qëndrim Zogaj avokat nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, me autorizim të datës 06.02.2024, dhe konform nenit 41 të LKA në mungesë të përfaqësuesit të të paditurit, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore të ftuar në mënyrë të rregullt, pala e paditur ftesën për seancë e ka pranuar me datë 09.08.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në kohën e parashtrimit të padisë e përfaqësuar nga “Kërveshi & Partners”, ka deklaruar se Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AVUK)-Inspektori Sanitar, me Vendim AUV.Ref.04/02-2333/2020 me datë 04.12.2020, e ka refuzuar ankesën e paditësit me arsyetim se Inspektorët Sanitar të AUV kanë vepruar konform Ligjit 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e pandemisë Covid-19 dhe konform kontrolleve për zbatimin e vendimit të qeverisë nr.01/39 te datës 01.11.2020. Paditësi e kundërshton vendimin e Inspektoratit Sanitar me pretendimin se është bërë vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, rrjedhimisht dhe aplikim i gabuar i të drejtës materiale prandaj mbi bazën e këtyre pretendimeve pala paditëse ka ushtruar ankesë me datë 06.11.2020.

5. Pala paditëse konsideron se me Vendimin AUV.Ref.04/02-2333/2020 me datë 04.12.2020, është referuar gabimisht baza ligjore, për arsye se Pala e paditur vendimin për shqiptimin e dënimit me gjobë e ka bazuar në Ligjin 07/L-006, neni 24 paragrafi 4 ku parashihet se: *“Personi juridik i cili nuk e zbaton vendimin e Organit Kompetent për krijimin e kushteve dhe mbajtjen e distancës së përcaktuar në hapësirat në të cilat janë përgjegjës dënohen me gjobë prej 500 euro ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë prej 200 euro”* qe parasheh ndëshkime për mos-respektimin e distancës dhe jo orarit të mbylljes së lokalit. Shqiptimi i gjobës i është shqiptuar subjektit afarist për mos respektimin e orarit të mbylljes së lokalit kurse baza ligjore në të cilën është thirrur paraqitësi i kundërvajtjes ka të bëjë me mbajtjen e distancës.

6. Pala paditëse konsideron se me pretendimet e të paditurës është bërë konstatimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike sepse Inspektorati Sanitar me rastin e inspektimit me datë 04.11.2020, në ora 21:10 ka konstatuar prezencën e klientëve brenda hapësirës afariste të paditëses por sipas paditësit në padi në kohën kur ka ndodhur inspektimi brenda kanë qenë vetëm punëtorët e autorizuar duke e pastruar marketin dhe nuk ka pasur prezencë të konsumatorëve duke u nisur nga fakti që janë zbatuar rekomandimet që lokalet të mbyllën në ora 21:00 prandaj edhe Qendra Tregtare ka qenë e mbyllur për konsumatorë në kohën e inspektimit. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike dëshmohet nga procesverbali i inspektimit, nr.003616 i datës 04.11.2020 ku personi përgjegjës i paditësit ka refuzuar të nënshkruajë për arsye se i njehti nuk është pajtuar me shqiptimin e gjobës me arsyetimin se konstatimet në të nuk kanë korresponduar me gjendjen faktike që dëshmohet edhe nga mungesa e provave materiale.

7. Pala paditëse kundërshton shqiptimin e gjobës nga e paditura sepse nuk ka siguruar asnjë provë ose dëshmi konkrete, fotografi të konsumatorëve apo kupon fiskal që të i mshështesë pretendimet e saj. Pala paditëse konsideron se e njehta është në kundërshtim me Ligjin për Kundërvajtje, neni 47, paragrafi 2 i cili parasheh se: *“Barra e të provuarit të kundërvajtjes dhe të përgjegjësisë së kundërvajtjes është në paraqitësin e kërkesës për fillimin e procedurës së kundërvajtjes”*.

Kundërshtimet e të paditurës

8. E paditura Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me seli në Fushë Kosovë, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore e Kosovës, në Përgjigje në Padi të datës 28.05.2024 e kundërshton padinë si të pabazuar, vlerëson se vendimi i atakuar është marrur konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë dhe se pretendimi i paditësit se vendimi është marrur me shkelje ligjore nuk qëndron sepse pala paditëse pretendimet e saj nuk i ka vërtetuar në asnjë provë të vetme.

Provat e administruara

9. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi i kundërshtuar AUV.ref.04/02-2333/2020 i datës 04.12.2020, i lëshuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i Kosovës; Procesverbal i inspektimit nga ISK me nr.003616 me datë 04.11.2020 në lokalitetin e paditësit; Ankesë nga paditësi e datës 06.11.2020 kundër Fletë përmbajtjes për Kundërvajtje të datës 04.11.2020; Vendim i Qeverisë për masa të veçanta për mbrojtje nga pandemia COVID-19 me nr.01/39 me datë 01.11.2020.

Vlerësimi i Gjykatës

10. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoi përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e të paditurës në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e pabazuar.
11. Gjykata konstaton se baza ligjore e vendimit të Inspektoratit Sanitar është në pajtim me Ligjin për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse nr. 07/L-006 (në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të kundërshtuar) ku sipas nenit 1 “Ky ligj ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19”; dhe neni 23 që përcakton “Masat ndëshkimore të përcaktuara me këtë ligj shqiptohen nga Policia e Kosovës, Inspektorati

shëndetësor, inspektorati farmaceutik, inspektorati sanitar dhe inspektoratet komunale.”.

12. Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në kompetencat ligjore për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse, ka marr Vendimin me nr. 01/39 të datës 01.11.2020, duke përcaktuar masat e veçanta për mbrojtjen nga pandemia COVID-19, të detyrueshme për të gjitha institucione publike, private dhe personat fizik, ku në pikën 20 theksohet se *“Të gjitha qendrave tregtare në tërë territorin e Republikës së Kosovës u ndalohet veprimtaria nga ora 21:00 deri në orën 05:00”*
13. Prandaj, gjykata vlerëson se e paditura Komisioni për shqyrtimin e ankesave në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë me Vendimi AUV.ref.04/02-2333/2020 i datës 04.12.2020, gjendjen faktike e ka vërtetuar bazuar në raportin e inspektimit të Inspektorëve Sanitar të realizuar tek qendra tregtare e paditësit, me datë 04.11.2020 në ora 21:10, me ç ‘rast Inspektorët kanë konstatuar se lokali ka qene ende i hapur dhe duke ju shërbyer klientëve pas orarit. Prandaj, vlerëson se gjoba e shqiptuar në vlerë prej 500 euro për mos-respektim të masave qeveritare Anti-Covid 19 është e bazuar ne Ligjin Nr. 07/L-006 (në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të kundërshtuar) Për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-2019. Meqenëse, paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë relevante për të kundërshtuar gjendjen faktike të konstatuar në raport të inspektimit, gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë dhe në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzoj ankesën e paditësit.
14. Gjykata vlerëson se paditësi përveç që i ka kundërshtuar konstatimet e Inspektoratit Sanitar me pretendim se shqiptimi i gjobës është bërë në bazë të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike se me rastin e inspektimit me datë 04.11.2020, në ora 21:10 nga Inspektorati Sanitar, janë hasur vetëm punëtorët duke e pastruar lokalin - nuk ka dorëzuar asnjë provë nga të cilat gjykata do të konstatonte një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar nga e paditura. Sipas Nenit 7 par. 7.1 të LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.*

15. Gjykata vlerëson se baza ligjore që bazohet shqiptimi i gjobës nga Inspektorati Shëndetësor është referuar gabimisht sa i përket paragrafit në Ligjin nr. 07/L-006 (në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të kundërshtuar) për Parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-2019 neni 24 paragrafi 4 ku theksohet se *'Personi juridik i cili nuk e zbaton vendimin e Organit Kompetent për krijimin e kushteve dhe mbajtjen e distancës së përcaktuar në hapësirat në të cilat janë përgjegjës dënohen me gjobë prej pesëqind (500) euro, ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë prej dyqind (200) euro'* sepse konsideron se paragrafi 1 i po të njëjtit nen, përbën bazë të mjaftueshme ligjore për shqiptimin e gjobës për arsye të shkeljes së vendimit në aspektin e kufizimit të qarkullimit dhe jo krijimit të kushteve ku theksohet *"Personi juridik i cili nuk e respekton vendimin e Organit kompetent për kufizimin e qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve në kohën e caktuar, dënohen me gjobë prej pesëqind (500) euro;"*. Gjykata duke e pasur parasysh që vlera e gjobës së shqiptuar është e njëjtë me lartësinë e ndëshkimit që parashihet në nenin që e rregullon çështjen konkrete dhe për arsye se konstatohet se kundërvajtja është kryer nga Personi juridik, referimi në bazën ligjore të paragrafit të saktë nuk ka ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

16. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi lidhur shpenzimet procedurale u vendos në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.475/22, me datë 30.08.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.